



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Integritime Evropiane  
Mbledhja nr. 18  
Prishtinë, më 10.11. 2008, ora 14:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**i mbledhjes së Komisionit për Integritime Evropiane**

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Džezair Murati, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova ndërsa munguan Hydajet Hyseni, Edita Tahiri dhe Branislav Grbić

Pjesëmarrës të tjerë: Michele Dinelli - UNDP, Maria Berisha - OSBE, Jules Caron - OSBE, Fitore Zeneli - KDI, Agron Demi - GAP, Avni Zuka - NDI, Jan Meyer-Universiteti i Bremenit dhe Federike Eünschmann.

I ftuar: Khaldoun Sinno.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 3. Prezantim i Raportit të Progresit nga ana e përfaqësuesit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian z. Khaldoun Sinno,**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/48, për Administratën Tatimore dhe procedurat nr.03/L-071/1, me amendamente të komisionit funksional , nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE,**
- 5. Të ndryshme.**

*Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen për shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## 3. Prezantim i Raportit të Progresit nga ana e përfaqësuesit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian z. Khaldoun Sinno.

**Kryesuesja** tha kemi Raportin e Progresin ne të cilin përshkruhet ajo çka është bërë dhe çka nuk është bërë nga ana e institucioneve të Kosovës. E lidhur me këtë tha janë dhënë kritika se çka duhet të bëjnë më shumë institucionet e Kosovës në pikat politike, ekonomike si dhe në implementimin e standardeve evropiane. Për ta elaboruar më shumë tha ia dha fjalën z.Sinno përfaqësues i Komisioni Evropian në Kosovë.

**Khaldoun Sinno** tha se ka qenë një javë e bujshme dhe po ashtu do të jetë edhe java tjetër pasi që ka interes shumë të madh për Raportin e Progresin. Ai shtoi se keni parë kumtesën për shtyp që thotë se viti 2009 është viti i zhvillimit pasi me Kroacinë do të fillojnë bisedimet për anëtarësim, Serbia ndoshta do të fitoj statusin e shtetit kandidat dhe Kosova do të ketë studimin e fizibilitetit. Arsyeja e hartimit të këtij raporti tha është se me te ne vlerësojmë se ku gjendet Kosova, ku ka nevojë për më shumë raportim dhe më shumë asistencë. Sa i përket vlerësimeve të cilat janë bërë tha ne e kuptojmë se në disa fusha ka pasur përgjegjësi faktori ndërkombëtarë. Sa i përket strukturës së Raportit tha është një strukturë e përafërt për të gjitha shtetet sa i përket raporteve me BE. Lidhur me burimet e informacioneve tha kemi një mori burimesh për informacione që nga Qeveria, Zyra Ndërlidhëse, organizatat e ndryshme si dhe nga mbledhjet e Komisioneve të Parlamentit. Si pika pozitive përmendi stabilitetin politik i cili është mbajtur mirë falë Qeverisë dhe Institucioneve të Kosovës. Kushtetuta është në vijë me standardet evropiane. Sa i përket integritimit rajonal tha Kosova ka qenë pjesë e tyre dhe ka luajtur rolë shumë të rëndësishëm. Sa i përket Kuvendit tha na është bërë e ditur se ju keni miratuar Rregulloren e Punës, janë krijuar komisione të reja ku një nga to është edhe Komisioni për Integritet Evropian. Si pika pozitive të ekonomisë paraqiti rritjen e ekonomisë, rritje kjo e nxitur nga sektori privat. Po ashtu si pikë pozitive tha është Konferenca e Donatorëve dhe Korniza e shpenzimeve menjëherë pas saj. Sa i përket standardeve evropiane tha shohim që disa ligje që janë miratuar edhe janë zbatuar. Në fushën e mjedisit, doganave dhe bujqësisë tha ka disa zhvillime të mira. Si sfida të cilat janë identifikuar tha janë çështja e kapacitetit administrativ. Shtoi se komunikimi ndërministrorë është përmirësuar por duhet të përmirësohet edhe më shumë. Ai shtoi se duhet të bëhen përpjekje më të mëdha sa i përket sundimit të ligjit, korrupsionit. Ne edhe në raport tha e kemi potencuar se Qeveria e Kosovës nuk e ushtron autoritetin e vetë në tërë territorin e vendit, që do të thotë se ekzistojnë institucione paralele të cilat e pengojnë Qeverinë andaj edhe nuk mund ta kritikojmë qeverinë për ato territore ku nuk ka ndikim. Sa i përket çështjes së pakicave tha ne kemi vërejtur se ekzistojnë mekanizmat por duhet bërë përpjekje që të integrohen sa më shumë. Çështja e privatizimit tha e dimë dhe kemi vënë në pah që është zhvilluar me vonesa. Shtoi se kemi vërejtur se duhen bërë më shumë investime për të pasur rritje ekonomike. Tha korniza legjislative është shumë e mirë por problemi paraqitet tek implementimi i tyre. Si konkludim tha nuk duhet ti lëmë gjërat

ashtu siç janë por qëllimi është që ti fuqizojmë dhe konkretizojmë ato. Të intensifikohen marrëdhëniet me Kosovën në radhë të parë duke rritur dialogun teknik politik

**Kryesuesja** shtoi se duke u bazuar në Raport del se një pjesë e madhe e institucioneve në krahasim me raportin e kaluar nuk kanë bërë ndonjë progres. Ajo hapi diskutimin dhe i ftoi deputetët që të paraqesin qëndrimet e tyre.

**Naser Rugova** sa i përket kritikave tek objektivat politike që janë demokracia dhe sundimi i ligjit tha flitet edhe për punën e Parlamentit. Ai shtoi se më shqetëson kritika shumë e rreptë që i është drejtuar organit më të lartë legjislativ të vendit kjo në një farë forme i bie sikur se Qeveria ta kishte zgjedhur Parlamentin e jo e kundërta. Te ne tha Qeveria ia cakton agjendën dhe punën e Parlamentit. Në raport kritikohet Qeveria edhe për ndërhyrje të drejtpërdrejtë në media. Ai kërkoi që Qeveria të ketë kujdes që ti trajtojë këto vërejtje pasi tha e dimë që mohimi i fjalës së lirë shpie në diktaturë. Sa i përket objektivat ekonomike tha po ta marrim vetëm sondazhin e fundit të Odës Ekonomike Amerikane tregon se mbi 60% e bizneseve kanë deklaruar se duhet ta korruptojnë dikë nga Qeveria dhe institucionet që të prosperojnë në punën e tyre, e nga kjo mund të konkludojm se a ka konkurrencë të lirë. Sa i përket funksionalizimit dhe menaxhimit të ndërmarrjeve publike tha deri më tani KEK-u ka gllabëruar mbi 1 miliard e 200 milion euro, kemi aferën me Dardafon, zgjedhja me dekret e drejtorit të Aeroportit e të gjitha këto të lënë shumë pak mundësi për të besuar se ka konkurrencë të lirë. Te standardet evropiane: lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar tha e kanë potencuar edhe mekanizmat ndërkombëtar dhe Kryeministri i vendit se mbi 35% në Kosovë mbizotëron ekonomia informale e cila në shifra është sa një buxhet i Kosovës. Ai tha se Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarr hapa që ti ndaloj këto veprime sepse fatkeqësisht nënvizohet që Qeveria aktuale nga shkurti i këtij viti ka rritje të dukshme të korrupsionit. Për fund tha nuk ka integritet me këtë mënyrë të punës së Qeverisë dhe me këtë qeverisje. Ai kërkoi që Qeveria të ndërmarr hapa konkret, ti marrë me seriozitet të gjitha vërejtjet e Raportit dhe të funksionalizoi të gjithë mekanizmat.

**Njomza Emini** tha sot u bë një paraqitje në vija të trasha e Raportit. Ajo shtoi se nuk kemi diçka konkrete të prezantuar nga ana e Qeverisë për luftimin e korrupsionit duke pasur parasysh se Qeveria ka proklamuar zero tolerancë për korrupsionin. Pyeti se e kujt mbetet përgjegjësia për ato dikastere në të cilat kanë qenë kompetencat e rezervuara dhe cilat standarde keni vërejtur se janë plotësuar deri më tani.

**Fatmir Rexhepi** tha se të gjitha këto vërejtje të cilat janë paraqitur në këtë raport e para ishte çështje politike dhe duhet ditur se sa ka hise bashkësia Evropa dhe EULEX i cili po vonon dhe prodhon probleme të mëdha politike duke mos respektuar Kushtetutën e Kosovës. Ai pyeti se a ka një vijë të kuqe në mes asaj që ka qenë e rezervuar për bashkësinë evropiane dhe Kosovën. Nëse vazhdojmë kështu s'do të ecim me dinamikën e paraparë. Sa i përket çështjeve nga sfera ekonomike tha i kemi kufijtë e vendit dhe nuk kemi kontrollin e tyre me çka cenohet sovraniteti. Ai tha se me këtë nuk po kërkoi të amnistoi Qeverinë dhe Parlamentin kur është në pyetje te implementimi i strategjive që kanë të bëjnë me energjinë, investimet në fushën e transportit sepse njësi matëse tha është rezultati e jo vullneti. Lidhur me çështjen e pakicave tha se kujt duhet ti hidhet faji që

serbët që 30 vite na kanë akuzuar neve. Pyeti çka duhet bërë më shumë që ti bindim se kanë hise edhe ata këtu për të ndërtuar këtë shtet. Ai propozoi që edhe bashkësia evropiane ti qaset më ndryshe këtij raporti sepse Kosova s'po qeveriset vetëm nga qytetarët e vetë por edhe nga bashkësia evropiane.

**Dzezair Murati** pajtohet me mendimet e parafolëseve se raporti është objektiv, por tha se më ngjalli interesim një fjali e z. Sinno sa i përket pakicave ku thuhet se statusi i pakicave teorikisht është i zgjidhur por praktikisht jo, si përfaqësues i komunitetit tha se as bashkësia ndërkombëtare dhe as institucionet e Kosovës nuk e kanë shfrytëzuar vullnetin e mirë të pakicave që të jemi shembull si të afrohem dy komuniteteve më të mëdha sa përket integritit, sepse Bashkësia ndërkombëtare po i favorizon serbët kurse me ta udhëheq Beogradi e jo institucionet e Kosovës dhe ka gabuar që iu ka lejuar udhëheqjen e Ministrisë për kthim sepse nga Kosova vetëm kanë shkuar dhe askush nuk është kthyer, Quket Ministri për komunitete por unë ia kisha ndërrua emrin dhe e kisha quajtur Ministri vetëm për serb ,sepse në këtë Ministri janë bërë shumë lëshime dhe pa drejtësi në dëm të komuniteteve jo serbe. Në vazhdim theksoi se Qeveria e Kosovës ende nuk ka strategji për integrimin e më tej të pakicave dhe vazhdimisht po kalohet në disa kërkesa kryesore, vizitoni Prizrenin si qytetin më të madh multi-etnik dhe nuk mund të shihni asnjë firmë të regjistruar ku gjeni mbishkrime në dy gjuhët, ku është pra barazia e ligjeve dhe kush duhet të përgjigjet pse është kështu .Ne i kemi tejkalua disa gjëra deri në rregullimin e statusit të Kosovës, pas pavarësisë së Kosovës i takojmë kësaj shoqërie por ende jemi të anashkaluar. Bashkësia ndërkombëtare nuk ka mësuar asgjë nga Dejtoni dhe ka lejuar që Serbia të qeveris në pjesën veriore të Kosovës. Një numër i madh i shteteve kanë njohtë pavarësinë e Kosovës por Bashkësia ndërkombëtare nuk po bënë asgjë ta ruajë Kosovën në kufijtë e saj integral. Në emër të bashkësisë sime protestoj pse misioni i EULEX është neutral në çështjen e Kosovës dhe ky mision duhet të deklaronte publikisht që duhet ta mbështes planin e Ahtisarit , Kushtetutën e Kosovës dhe barazinë e të gjitha komuniteteve dhe pse i lejohet Beogradit në një shtet të pavarur të përzihet. Si qytetar i Kosovës dhe si pjesëtar i komunitetit tim, protestoj pse po bëhet kështu me Kosovën dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të jetë më reale ndaj çështjes së Kosovës sepse shumë po taktizohet dhe po luhen lojëra të ndryshme në dëm të Kosovës.

**Nait Hasani** lidhur me raportin tha se i njëjti është prezantuar edhe nga ana e Qeverisë dhe është pranuar si raport real. Shtoi se edhe Qeveria e ka pranuar se ka korrupsion dhe ka paraqitur luftën kundër korrupsionit. Si pengesë tha po paraqitet mos zgjedhja e gjyqtarëve nga ana jonë por emërimi nga ana e mekanizmave ndërkombëtarë. Ky emërim na e ka pamundësuar ne që të kërkojmë nga ta përgjegjësi dhe raport, e këtë më së miri tha e elaboron numri i madh i rasteve të pa zgjidhura. Shtoi kemi një Agjensoi Kundër korrupsionit i cili ka dalë me një raport jo formal në bazë të cilit përgjegjës nuk është askush. Sa i përket ekonomisë informale ajo tha zhvillohet në veri të Kosovës. Njoftoi se vetë mekanizmat ndërkombëtarë kanë caktuar tri shkallë të tatimit të mallrave dhe ky është dëmi i cili po i shkaktohet buxhetit. Sa i përket çështjes së pakicave tha se janë plotësuar dhe tejkaluar standardet evropiane dhe këto janë të garantuara edhe me Kushtetutë por këto s'mund të realizohen brenda natës. Po ashtu ne tha nuk e kemi regjistrimin e popullsisë andaj nuk kemi të dhëna në bazë të cilave do të dinim

proporcionin e popullatës shumicë me atë pakicë. Bashkësia Ndërkombëtare tha i ka tejkaluar masat e tyre me ndërhyrjet e tyre në punët e brendshme të Kosovës. Shtoi se nuk duhet të kemi dy pushtete në Kosovë dhe se BE po prodhon krizë në Kosovë.

**Bujar Bukoshi** shtoi se është e lehtë në këto rrethana të caktohet diagnoza por duhet të dimë si të gjinden rrugë që të kemi progres raport shumë më të mirë se këtë që e kemi këtë vit. Ai shtoi se vetëm pala kosovare nuk mund t'ia dalë vetë me të gjitha këto probleme të trashëguara dhe të fituara nga prezenca e bashkësia ndërkombëtare, por kjo duhet të bëhet me asistencën e Bashkimit Evropian. Ai përkujtoi “kontributin” negativ të bashkësisë ndërkombëtare. Për fund kërkoi që përveç qëndrimit destruktiv të Serbisë karshi Kosovës të mos ketë edhe import të konfuzionit nga ana e bashkësisë evropiane.

**Sabri Hamiti** propozoi, kur të bëhen raporte të tilla për Kosovën të bëhen më të strukturuar sidomos sa i përket relacionit të Kosovës me Bashkësinë Ndërkombëtare. Ai shtoi shumë probleme janë derivime të kulluara politike. Shtoi Kosova e ka shpallur vullnetin e vetë me shpalljen e pavarësisë. Tha kemi Kushtetutë shumë moderne, por sa funksionon nuk e thotë askush sepse për mos funksionimin e saj nuk është fajtor vetëm Qeveria por edhe institucionet e degazhuara në Kosovë të cilat i marrin detyrat sipas asaj Kushtetute. Ai shtoi ne e kemi thirrur EULEX me Kushtetutë por dyfishimi i EULEX dhe UNMIK ka sjellë konfuzionin më të madh të dhjetëvjetëshit të fundit. Shtoi se një delegim i tillë i BE që mbulon dy sektor të mëdhenj duhet po ashtu të ketë përgjegjësin ndaj asaj Kushtetute që e ka prurë si institucion EULEX-in në Kosovë. Ai propozoi që analizat të pjesëtojnë përgjegjësin e Bashkësisë Evropiane në sektorin e drejtësisë dhe sigurisë fusha këto në të cilat Kosova nuk ka pasur sovranitet dhe të cilin se ka as sot. Ai shtoi se ne vetëm mund të bëjmë diferencimin e pushtetit dhe të dihen përgjegjësit e secilit institucion por te ne tha nuk ndodhë sepse teoria e gjanësisë e lejon mundësin më të madhe për manipulim. Sa i përket ekonomisë informale tha është diçka që e kanë të gjitha vendet e Ballkanit dhe disa vende të BE dhe nuk është diçka që po ndodh vetëm te ne.

**Khaldoun Sinno** tha nuk do të thotë se nëse ka korrupsion në ndonjë shtet të rajonit dhe te ju, ju të mos merreni me të. Lidhur me EULEX tha nuk do të flas për te pasi diskutimet janë ende në vazhdim e sipër. Sa i përket çështjes së përgjegjësisë së ndërkombëtarëve dhe emërimit të gjyqtarëve tha se raporti është i shkruar duke u bazuar në atë se çka kemi parë dhe dëgjuar për atë se çka ka ndodhë në Kosovë në tërësi nën të gjitha autoritetet. Shtoi se e dimë që Qeveria e Kosovës nuk e ushtron autoritetin e vetë në tërë territorin e saj. Ai shtoi sa i përket krimin të organizuar nuk ka një planë strategjik se si të merren me të. Sa i përket zbatimit të ligjit tha sikur të ishin përfaqësuesit serb nuk e di në do të thoshin se ata janë pjesa më e mbrojtur. Shtoi kemi ligjin për gjuhët por nuk kemi rregullore në nivel lokal për ta zbatuar atë e kjo e dëshmon atë se kemi legjislacion të mirë por nuk zbatohet e më çka ndikon te të gjitha komunitetet. Sa i përket komponentës ekonomike tha se ndikon te të gjitha komunitetet dhe e dimë se integrimi kushton shumë dhe pakoja e Ahtisarit është shumë e kushtueshme për Kosovën. Aspekte pozitive tha është se ka ulje të numrit të papunësisë. Shtoi se raporti ynë mund të ju duket pak sa i rreptë por e njëjta gjë është edhe me vendet e rajonit sepse janë probleme serioze dhe duhet të merreni me to. Lidhur me raportin tha se duhet ta merrni si rekomandim nga shoku. Shtoi, Kosova nuk duhet të mbahet peng nga vullneti i komuniteteve. Ju jeni

komisioni kyç për çështjen e integriteteve andaj është e arsyeshme që ju intereson të dini më shumë lidhur me raportin. Të gjitha institucionet janë të obliguara për progresin e arritur.

**Kryesuesja** e falënderoi z.Sinno për paraqitjen e raportit

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e dt.21.10. 2008 dhe dt.28.10.2008**

**Kryesuesja** konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e datës 21 dhe 28.10.2008 u miratuan pa vërejtje.

## **4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/48, për Administratën Tatimore dhe procedurat nr.03/L-071/1, me amendamente të komisionit funksional , nga aspekti i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE.**

**Kryesuesja** ftoi deputeten Njomza Emini, referuese e këtij projektligji që të paraqes analizën e saj lidhur me pajtueshmërinë e projektligjit.

**Njomza Emini** tha se Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/48, për Administratën Tatimore dhe procedurat nr.03/L-071/1, me amendamente të komisionit funksional është në pajtueshmëri me acqiuon komunitare.

**Kryesuesja**, konstatoi se Komisioni nxori këtë

### **Përfundim**

**Komisioni konstatoj se Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/48, për Administratën Tatimore dhe procedurat nr.03/L-071/1, me amendamente të komisionit funksional nuk i cenon parimet themelore të Acquis Communautaire dhe politikat e BE-së.**

## **5. Të ndryshme**

### **a) Për Grupet Punuese të PVPE**

**Nait Hasani** njoftoi rreth funksionimit dhe punës së GP për Tregun e Brendshëm dhe se mbledhja e radhës e këtij grupi do të jetë me datë 6 dhe 24 dhjetor 2008.

**Naser Rugova** njoftoi se ka marrë pjesë ne GP për Inovacione, i cili grup udhëhiqet nga sekretari permanent i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ai shtoi se ky grup është multisektorial dhe se ka hartuar planin e punës.

### **b)Reagim ndaj vendimit të Kryesisë së Kuvendit**

**Kryesuesja** i njoftoi anëtarët e komisionit se Kryesia e Kuvendit ka marrë vendim që Komisioni për Punë të Jashtme të bëjë kontrollin e të gjitha ftesave që bëhen për

deputetët. Propozoi që të shkurtojmë procedurat për realizimin e vizitave të reagohej ndaj këtij vendimi.

**Sabri Hamiti** njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisioni për Punë të Jashtme nuk është paraparë që të kontrolloj vizitat por të jap një rekomandim dhe të koordinoj vizitat në mënyrë që të mos pengohet puna e Kuvendit.

Pas shqyrtim të vendimit nga ana e deputetëve Bujar Bukoshi, Nait Hasani dhe Naser Rugova,

**Kryesuesja**, konstatoi se Komisioni nxori këtë

### **Përfundim**

Në mënyrë që të mos zgjaten procedurat për realizimin e vizitave të reagohej ndaj vendimit të Kryesisë me të cilën është vendosur që Komisioni për Punë të Jashtme të rekomandoj për realizimin e vizitave dhe të jepet propozimi për krijimin e një mekanizmi për bashkërendimin e diplomacisë parlamentare.

**Mbledhja përfundoi në orën 16:10min.**

**Përgatiti**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit**

**Zylfije Hundozi**